



08/07/2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr. 21, datë 08.07.2025

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË AMBALAZHUAR, ME
VENDNDODHJE: NJËSIA ADMINISTRATIVE QELËZ, BASHKIA
PUKË

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës "Për leje për përdorim burimi ujqor nëntokësor për ujë të ambalazhuar në rastin kur përdorimi është për ≤ 150 shishe/orë, ≤ 1 l/sek", të subjektit "KOLA" sh.p.k, me vendndodhje Njësia Administrative Qelëz, Bashkia Pukë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujqor, koordinatat KRGJSH:

- X=497085
- Y=4664641
- Z=1471.8 m

Sasia e ujit që do të përdoret $Q = 0.5$ l/s

Prurja mesatare vjetore: $Q = 0.8 \text{ l/s}$

Vendndodhja e pikës ku do të shfrytëzohet uji (Koordinatat KRGJSH):

- $X = 492612$
- $Y = 4662655$
- $Z = 538 \text{ m}$

3. Zbatimi i lejes nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBL DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

